

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	CNN: Pesë të arrestuar pranë një baze ajrore në Angli, dyshime për terrorizëm dhe eksplozivë
ADRESA	https://kohajone.com/aktualitet/cnn-pese-te-arrestuar-prane-nje-baze-ajrore-ne-angli-dys-hime-per-terrorizem-dhe-eksplozive/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 14:25:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 14:21:20 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	260b83cbcb7cdec4311b596283a7afd6cab3b35fb30e3c0efa0e70cf4490b601
TEKSTI	1ed09c78355a3ba6a7da43e30eba47ad83b8323881847a97cd58e976eae3a163
PAMJA	1c0f90ee98c9fb0d049cba5968f5120dced5cfa480efa6c5b87d269c22e24302

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5e8e0446e82abe6c42d15a98f2fdf7b9a54c6b1bcdafa7bc1b05d77fa7b7b642
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3dbf5264f26ae921c8f8735760cb378b1b626a14b73f487ffe641eb8f02fca55
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5e8e0446e82abe6c42d15a98f2fdf7b9a54c6b1bcdafa7bc1b05d77fa7b7b642>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

CNN: Pesë të arrestuar pranë një baze ajrore në Angli, dyshime për terrorizëm dhe eksplozivë

AKTUALITET BOTA E DIEL, 27 SHTATOR 2026 16:21



Policia në një bllokim rrugor në rrugën për në RAF Fairford pas shpalljes së një incidenti të madh, me policë të armatosur që mbajnë një kordon pranë fshatit Whelford në Gloucestershire, pranë RAF Fairford i cili përdoret nga Forcat Ajrore të Shteteve të Bashkuara (USAF). Data e fotos: E diel, 27 shtator 2026. Ben Birchall/PA Wire

Policia britanike ka arrestuar pesë burra pranë bazës së Forcave Ajrore Mbretërore në Fairford, në Gloucestershire, e cila përdoret edhe nga forcat ajrore amerikane dhe nga bombardues strategjikë me rreze të gjatë veprimi. Të arrestuarit dyshohen për vepra penale që lidhen me lëndë plasëse dhe për përgatitjen e një akti terrorist.

Njësitë e ushtrisë britanike për çaktivizimin e bombave janë dërguar në vendngjarje, ndërsa dhjetëra banesa në zonën përreth janë evakuuar si masë paraprake. Hetimet vijojnë.



KOHA JONË

Na ndiqni në YouTube

SUBSCRIBE

Sipas Richard Ocone, një detektiv i lartë në Gloucestershire, arrestimet u kryen pas informacioneve të marra nga banorët e zonës, pak pas mesnatës. Identitetet e pesë burrave nuk janë bërë publike dhe autoritetet nuk kanë dhënë ende të dhëna për një motiv të mundshëm.

Vicki Evans, oficer e lartë e Policimit Kundër Terrorizmit, tha se hetimi ndodhet në fazat e para dhe se pesë personat vazhdojnë të mbahen në paraburgim.

"Jemi në fazat e hershme të një hetimi dhe pesë burra mbeten në paraburgim. Siç do të pritej, ne po punojmë ngushtë me partnerët tanë për të kuptuar rrethanat e incidentit", deklaroi ajo.

Përveç dyshimeve për vepra penale që lidhen me eksplozivë, policia kundër terrorizmit bëri të ditur se pesë burrat janë arrestuar edhe nën dyshimin për "përgatitjen e një akti terrorist". Legjislacioni britanik kundër terrorizmit u jep autoriteteve kompetenca të posaçme për mbajtjen në paraburgim të personave të dyshuar, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara nga ligji.

Operacioni pranë pyllit

Pamjet ajrore të publikuara nga mediat duket se tregojnë një robot të çaktivizimit të bombave duke lëvizur mes tre furgonëve të bardhë në një zonë pyjore pranë bazës. Dy prej furgonëve kishin dyert e pasme të hapura, ndërsa pranë

LAJMET KRYESORE



Mesazh urgjent i kryeministrit Rama sapo mbërriti nga SHBA (fjala e plotë)



A do të shkojë ambasadori Wendt në Selinë Blu për të takuar Berishën?



Shqipëria fiton me dy gola ndaj Bjellorusisë



Mirë se vjen, Ambasador Wendt!



Presidenti Begavida zbardh takimin me ambasadorin e ri të SHBA, Eric Wendt

TË PËRZGJEDHURA



Singapori paguan qytetarët për të lexuar: 15 minuta në ditë në këmbim të parave



David Beckham merr 39 milionë paund dividend, marrëveshjet e Kupës së Botës nxisin fitime rekord



Ish-ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu te Nikoll Lesi: Nuk ka ministra hije! Balluku-lokomotivë shtetfo...



Sukses i menjëhershëm për Muse të Metës: Mjeti i AI tejkalon rivalët si ChatGPT dhe Claude



Inteligjenca artificiale mund të jetë më e rrezikshme se bomba atomike. Robotët e vitëve 2030, 2040, 2...

MË TË LEXUARAT

tyre dalloheshin disa objekte te medha me ngjyre te zeze.

Daily Mail publikoi gjithashtu pamje qe, sipas saj, tregojnë disa nga personat e arrestuar në orët e para të së dielës, sipas orës lokale. Në pamje, ata shfaqen pa bluza dhe me duart pas shpine.

Një banore e zonës i tha CNN se kishte dëgjuar helikopterë mbi fshat rreth orës 2:00 të mëngjesit, ndërsa automjetet e ekipeve të specializuara për eksplozivët kishin mbërritur rreth një orë më vonë.

Incidenti ka tërhequr vëmendje të veçantë për shkak të afërsisë me RAF Fairford, një bazë me rëndësi strategjike për praninë ajrore amerikane në Mbretërinë e Bashkuar.

Baza është përdorur nga bombardues amerikanë B-1 dhe shërben si një pikë operative e avancuar për Komandën Globale të Sulmeve të Forcave Ajrore të SHBA-së, përgjegjëse për operacionet ajrore me rreze të gjatë veprimi.

Një zëdhënës i forcave ajrore amerikane në Fairford, ku është vendosur edhe Krahui i 501-të i Mbështetjes Luftake, tha për CNN se, për arsye të sigurisë operacionale, nuk mund të bëheshin publike detaje mbi masat konkrete të mbrojtjes së forcave.

"Njësitë mbetet vigjilente dhe do të ndërmarrë veprimet e duhura për të garantuar sigurinë e anëtarëve të shërbimit amerikan, personelit civil, kontraktorëve dhe familjeve të tyre", tha zëdhënësi.

Kryeministri mbahet i informuar

Qeveria britanike tha se kryeministri po merr përditësime lidhur me incidentin.

"Jemi mirënjohës ndaj shërbimeve të emergjencës, të cilat kanë vepruar shpejt për të ndaluar disa të dyshuar dhe për të vendosur masa për të mbajtur komunitetin të sigurt", deklaroi një zëdhënës i qeverisë.

Ai shtoi se do të ishte e papërshtatshme të bëheshin komente të mëtejshme ndërsa hetimi është në zhvillim.

Edhe Sekretari i Mbrojtjes i Mbretërisë së Bashkuar, Wes Streeting, deklaroi se autoritetet po e trajtonin situatën dhe se strukturat e reagimit emergjent dhe Forcat e Armatosura ishin në gatishmëri.

Siguria rreth bazës ishte shtuar prej javësh

Banorë të zonës kanë dëshmuar se masat e sigurisë rreth Fairfordit ishin shtuar edhe para incidentit.

Një banor, i cili kërkoi të mos identifikohet, i tha PA Media se gjatë javëve të fundit ishin vendosur mjete të rënda pranë hyrjeve të bazës.

"Ata kanë vendosur automjete të rënda, shumë të rënda, përgjatë të gjitha portave... traktorë shumë të mëdhenj dhe gjëra të tilla", tha ai.

Një tjetër banor i tha CNN se baza dukej se kishte qenë praktikisht e izoluar gjatë ditëve të fundit.

"Ka qenë si një qytet fantazmë gjithë javën", tha banori.

Fairfordi dhe tensionet me Iranin

Rëndësia strategjike e RAF Fairford është bërë edhe më e dukshme në kontekstin e tensioneve të fundit ndërkombëtare.

Sipas materialit të raportuar, në mars qeveria britanike i dha forcave ajrore amerikane leje për të përdorur Fairfordin në operacione kundër objektivave iraniane, në një periudhë kur raketat iraniane po kërcënonin anijet në Ngushticën e Hormuzit.

Muaj më vonë, Mbretëria e Bashkuar deklaroi se forcat e saj të armatosura ishin të përgatitura për të përballuar çdo kërcënim, pasi Garda Revolucionare e Iranit kishte paralajmëruar lidhur me përdorimin e bazave britanike nga bombarduesit amerikanë.

"Forcat tona të Armatosura janë të gatshme ta mbajnë Mbretërinë e Bashkuar të sigurt nga çdo lloj sulmi, qoftë në tokën tonë apo nga jashtë. Mbretëria e Bashkuar është e gatshme 24/7 për të mbrojtur veten", deklaroi një zëdhënës i qeverisë.

Për momentin, autoritetet britanike nuk kanë bërë të ditur nëse incidenti pranë Fairfordit ka ndonjë lidhje me objektet ushtarake amerikane, me zhvillimet ndërkombëtare apo me ndonjë motiv tjetër. Hetimi mbetet në fazat e para dhe pesë personat vazhdojnë të jenë në paraburgim.

AV/KJ

MË SHUMË NGJA AKTUALITETI





Tedi Blushi i drejtohet Ramës:
“Shporrja, dhe vetëm shporrja, është e...”

Polonia ofrohet ‘të strehojë’
fabrikën e sistemeve “Patriot” për Ukrainën



Nënkryetari i PD, Belind Këlliçi:
Edi Rama nuk do ta mbajë dot me forcë pushtetin!



“Rasti Ante Gotovina” nisi të
përmendej nga avokatët, si pikë referen...



Zoti Rama: Cilët janë mediat me
evazion “marramendës fiskal”?



Mblidhen “Plisat” kundër
aktgjykimit në Hagë, protestës u bashkohen e...

LAJMET E FUNDIT



CNN: Pesë të arrestuar pranë
një baze ajrore në Angli,
dyshime për terrorizëm dhe
eksplozivë

[1 MINUTË MË PARË](#)



Tedi Blushi i drejtohet Ramës:
“Shporrja, dhe vetëm shporrja,
është e vetmja zgjidhje që
duhet ta marrin në dorë shqij...”

[10 MINUTË MË PARË](#)



Polonia ofrohet ‘të strehojë’
fabrikën e sistemeve “Patriot”
për Ukrainën

[22 MINUTË MË PARË](#)



Nënkryetari i PD, Belind Këlliçi:
Edi Rama nuk do ta mbajë dot
me forcë pushtetin!

[28 MINUTË MË PARË](#)



“Rasti Ante Gotovina” nisi të
përmendej nga avokatët, si pikë
reference për fazën e apelit të
Çlirimtarëve

[43 MINUTË MË PARË](#)



Zoti Rama: Cilët janë mediat me
evazion “marramendës fiskal”?

[52 MINUTË MË PARË](#)

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

KOHA JONË

Gazeta “KOHA JONË” themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga “Samir Frasheri”, Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.